



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



OJQ - Radio Focus
Nr. i regjistrimit 5101247-0
Drejtor – Gligorije SARIC
Radio Focus
Rr/Vistanicka p.n.
Rahovec

“Radio Aktiv” Sh.p.k.
Nr. i biznesit 71312178
Pronar i ri: Elvane HASKU
Rr/Xhelal Hajda Toni p.n.
Rahovec

Ref: 1706/607/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë së Radio Focus dhe bartjen e saj nga OJQ – Radio Focus në “Radio Aktiv” Sh.p.k., ndryshimin e skemës programore dhe të emrit në Radio Aktiv

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Focus është Ofrues i Shërbimit Medial Audio, i cili është i licencuar për transmetimin tokësor të audio programeve në gjuhën serbe, në Komunën e Rahovecit. Radio Focus është radio stacion me mbulueshmëri lokale.
3. Më datën 23 mars 2017, Radio Focus ka parashtruar një kërkesë për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e saj nga OJQ - Radio Focus tek “Radio Aktiv” Sh.p.k. me pronare znj. Elvane HASKU.
4. Radio Focus, përmes kërkesës së njëjtë, ka kërkuar miratimin e KPM-së edhe për ndryshimin e skemës programore, e cila aktualisht përmban program në gjuhën serbe, me skemën e re programore për transmetim të programeve në gjuhën shqipe.
5. Gjithashtu, Radio Focus ka kërkuar edhe miratimin e KPM-së për ndryshimin e emrit në Radio Aktiv si dhe ka njoftuar KPM-në se do të ketë edhe ndryshime në stafin menaxherial, pozita e personit përgjegjës për qështje programore dhe personit përgjës për qështje teknike.

Arsyetimi

6. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
7. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
8. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
9. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.”*
10. Komisioni është njoftuar zyrtarisht nga pronari aktual i Radio Focus se arsyeja e parashtrimi të kërkesë për ndryshimin e pronësisë së Radio Focus janë vështirësitë financiare, për çka edhe rrezikohet mbyllja e këtij subjekti.
11. Komisioni konsideron se kërkesa e parashtruar për ndryshimin e pronësisë së Radio Focus është dorzuar në pajtim me Ligjin e KPM-së, Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2017/02, Rregulloren për Tarifën Vjetore për Licencë KPM – 2017/03 si dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.
12. Komisioni konsideron se skema programore e propozuar për ndryshim është në interes të shërbimit publik, me që shumica e banorëve që jetojnë në Komunën e Rahovecit i përkasin komunitetit shqiptar.
13. Komisioni konstaton se kandidati ka dorëzuar dëshmitë e nevojshme lidhur me kualifikimet e stafit të ri menaxheriale në pajtim me aktet nënligjore të KPM-së.
14. Komisioni konstaton se emri i propozuar për ndryshim “Radio Aktiv”, nuk është i ngjajshëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe se gjatë përdorimit të tij për identifikim nuk do të shkaktoj konfuzion tek dëgjuesit, dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim të ndryshimit.
15. Komisioni ka vërtetuar se kandidati ka kryer të gjitha obligimet lidhur me tarifën vjetore të licencës së KPM-së.
16. Komisioni konsideron se kërkesa e Radio Focus për ndryshimin e pronësisë, skemës programore dhe emrit është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

Vendim

17. Komisioni në takimin e mbajtur më datën 27 qershor 2017 që të marrë vendim për ndryshimin e pronësisë së Radio Focus dhe bartjen e licencës nga OJQ – Radio Focus, në personin juridik “Radio Aktiv” Sh.p.k.; të ndryshojë emrin si dhe skemën programore, sipas kërkesës së parashtruar.
18. Pjesa 2 dhe 4 e Licencës së KPM-së nuk ndryshohet, kështu që, parametrat teknik si dhe mbulueshmëria mbeten të njëjtë, ashtu siç kanë qenë të përcaktuara në licencën e Radio Focus, përfshirë edhe afatin e vlefshmërisë së licencës.

Lëshimi i Vendimit

19. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



04.07.2017

datë